

| | |
|---|------------------------|
| REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA E KOSOVES AGENCIA PER KUNDERVAJTJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Nr. Prot D-P | Nr. Prot 03-4533/11 |
| Data 18-11-2011 | Data 18-11-2011 |
| PRISHTINE | |

2

Nr. regj. 24922/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurës Burbuqe (Abdyl) Berisha, nga Prishtina, për kundërvajtjet nga neni 6 par. 2 të ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 7 të ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195, 199 dhe nenit 13 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 18.11.2011 merr këtë:

AKTVE N D I M

E PANDEHURA: Burbuqe (Abdyl) Berisha, e lindur më 28.05.1970 në Luboten të Shkupit R. Maqedonisë, me vendbanim në Prishtinë, Lagja "Dardania" SU-4/2 LA nr. 6, ka të kryer fakultetin, e pamartuar, e gjendjes së mirë ekonomike, më parë e padënuar,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

1. Sepse pas emërimit në pozitën e Drejtoreshës së Teatrit të Kosovës në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, -
 - me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, dhe
2. Sepse si zyrtare e lartë publike në pozitën e Drejtoreshës së Teatrit të Kosovës në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarinimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2011, në Agjencinë kundër korrupsionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, -
 - me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 6 par. 2 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

- për kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, **dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, dhe**
- për kundërvajtjen nga neni 6 par. 2 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik **dënimi me gjobë në shumë prej 300 (dyqind) €, andaj në bazë të nenit 13 LK i shqiptohet një dënimi unik me gjobë në shumë prej 450 (katërqindpesëdhjetë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30(tridhjetë) ditësh, duke llogaritur për çdo 15 €, nga 1(një) ditë burgu.** Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor e pandehura është e obliguar ta paguajnë në shumën prej nga 5 €, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

Ar sy e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-3224/2011 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Burbuqe Berishës, për kundërvajtjet nga neni 6 paragrafi 2 dhe neni 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, duke kërkuar që e njëjta të shpallët përgjegjëse dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se për shkak të obligimeve të mëdha në punë nuk ka arritur ta deklaroj pasurin me marrjen e pozitës Drejtoreshës së Teatrit Kosovës në Prishtinë, e as deklarimin vjetor deri më datën 31 mars dhe nuk e ka pasur njohuri se mos deklarimi me kohë i pasurisë është i ndëshkueshëm. Ajo ka qenë e informuar nga ana e personit kontaktues përmes një e-mail për obligimin në fjalë, por për shkak të neglizhencës dhe obligimeve të mëdha nuk ka arritur ta kryen këtë obligim. E pandehura e ka sjell Vërtetimin me numër të protokollit 03-3740/11 të datës 28.09.2011 i lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit që ka dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë më datë 28.09.2011.

Nga të dhënat në kërkesë, Vendimit nr. 29828/2009 të datës 05.11.2009, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me të cilin e njëjta është emëruar në postin Drejtoreshës së Përgjithshme të Teatrit Kombëtar të Kosovës, nga vlerësimi i deklaratës së të pandehurës si dhe vërtetimit me numër të protokollit 03-3740/11 të datës 28.09.2011 i lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, e vlerësimit të shkresave të tjera të lëndës, secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja konstatoj këtë gjendje faktike: se e pandehura Burbuqe Berisha si zyrtare e lartë publike në pozitën e Drejtoreshës së Teatrit të Kosovës, në Prishtinë, nuk e ka deklaruar pasurin me marrjen e detyrës së drejtoreshës e as deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2011, andaj në masë të mjaftueshme vërtetoi se Burbuqe Berisha ka kryer kundërvajtjet të cilat me kërkesë i vihen në barrë.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurës, shkallën e përgjegjësisë, poashtu duke pas parasysh se në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ka qenë në fuqi Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-15, i cili është më i favorshëm për palën, gjyqtaria aplikoj ligjin në fjalë, ndërsa si rrethanë lehtësuese murr faktin se e njëjta e ka deklaruar pasurin më vonë dhe atë më datë 28.09.2011, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj i shqiptoi një dënim unik për dy kundërvajtjet si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe e pandehura në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 24922/2011, më datë 27.10.2011

Gjyqtaria

Azra Cakolli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.